

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**


Büro Kosovo

PSE EDUKIMI I HERSHËM ËSHTË ZGJIDHJA?

AUTORE:
MAJLINDA BEHRAMI
FITIM PACOLLI
FLORENT RAMQAJ



KOSOVA
që duam





Ky publikim është punë vullnetare e autorëve, përkrahur nga **Friedrich Ebert Stiftung**, zyra në Prishtinë. Përmbajtja, qëndrimet dhe përfundimet në këtë publikim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht i paraqesin edhe qëndrimet e Fondacionit **Friedrich Ebert Stiftung**.

Publikimi është i qasshëm online në: www.fes-kosovo.org

MIRËNJOHJE

Shprehim mirënjohjen tonë për të gjithë pjesëmarrësit që i kontribuan publikimit të këtij hulumtimi duke ndarë me ne përvojën, ekspertizën dhe përgjegjësitë e punës së tyre. Falënderojmë prindërit pjesëmarrës në fokus grupe, drejtoret e institucioneve parashkollore të Komunës së Prishtinës për bashkëpunimin e mirë, përfaqësuesit e institucioneve, ekspertët e fushës së edukimit të hershëm, psikologët dhe përfaqësuesit e organizatave jo qeveritare për kontributin e tyre në këtë hulumtim. Falënderojmë veçanërisht profesoreshën e Fakultetit të Edukimit, departamenti i edukimit të hershëm të fëmijëve në Universitetin e Prishtinës, Prof. Ass. Dr. Arlinda Beka për mbështetjen dhe kontributin e saj profesional në këtë hulumtim.

Falënderojmë Fondacionin Gjerman “Friedrich Ebert Stiftung” (FES) zyra në Prishtinë për mundësinë për të qenë pjesë e Akademisë Politike 2019, gjatë së cilës ka lindur ky bashkëpunim dhe iniciativa për këtë hulumtim, si dhe për përkrahjen financiare për realizimin e këtij publikimi. Falënderojmë në veçanti ish-drejtorin e FES në Kosovë z. Frank Hantke për mbështetjen e vazhdueshme përgjatë këtij hulumtimi, Mevlyde Hysenin dhe Jeta Loshaj, Koordinatorë të Programit në FES. Falënderojmë kolegët tanë, pjesë të Akademisë Politike 2019 për kontributin e dhënë në fillim të kësaj ideje, në veçanti Saranda Sylejmanin për kontributin e dhënë në këtë hulumtim.

SHKURTESAT

DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
FES	Friedrich Ebert Stiftung
IP	Institucione Parashkollore
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
KBKSAF	Kurrikula Bërthamë për klasat përgatitore dhe arsimin fillor
KEC	Kosova Education Center
KEPK	Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë
KKAKP	Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar
KSNA	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit
LAK	Ligji për Arsimin në Komunitet
LAP	Ligji nr. 04/ L-032 për Arsimin Parauniversitar në Kosovë
LEP	Ligji mbi Edukimin Parashkollor
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
PSAK	Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
SMIA	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim
SPSS	Paketa Statistikore për Shkencat Sociale
SZHMFH	Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç
UA	Udhëzimet Administrative
UP	Universiteti i Prishtinës

PËRMBAJTJA

SHKURTESA	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
Metodologjia	10
ZHVILLIMI I HERSHËM I FËMIJËVE; INVESTIMI NË EDUKIM, INVESTIM NË TË ARDHMEN	12
Zhvillimi i trurit të fëmijut	12
Socializimi i fëmijëve, ndikimi i kopshteve	13
Rëndësia e lojës në zhvillimin e fëmijëve	14
Investimi në edukim, investim në të ardhmen	15
KORNIZA LIGJORE E KOSOVËS LIDHUR ME EDUKIMIN E HERSHËM	16
Edukimi parashkollor	19
Edukimi parafillor – klasat përgatitore	20
Kurrikula për edukimin parashkollor	21
SISTEMI I EDUKIMIT PARASHKOLLOR NË KOMUNËN E PRISHTINËS	22
Format e organizimit të edukimit parashkollor	23
Institucionet parashkollore publike	23
Institucionet parashkollore private	23
Qendrat me bazë në komunitet	23
Institucionet parashkollore me partneritet publiko-privat	24
Kopshtet me bazë në komunitet	24
Edukimi i hershëm nga perspektiva e prindërve	27
Investimi në edukim të hershëm për fuqizim të grave	33
REKOMANDIMET	37
Bibliografia	38
Shtojcat	40
Shtojca 1. Informata demografike	40
Shtojca 2. Pyetësori	41

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky hulumtim ka identifikuar rëndësinë e edukimit të hershëm në zhvillimin e fëmijëve, mënyrën e organizimit të institucioneve parashkollore (IP) në komunën e Prishtinës dhe sa do t'i ndihmonte pozitës së grave në shoqëri rritja e numrit të IP-ve. Përmes rezultateve të këtij hulumtimi do të avokohet për ngritjen e vetëdijes së shoqërisë lidhur me rëndësinë e edukimit të hershëm, në veçanti tek prindërit dhe institucionet. Rezultatet e këtij hulumtimi do t'u shërbejnë prindërve, komunave dhe institucioneve relevante për t'a vënë edukimin e hershëm të fëmijëve si prioritet në agjendat e tyre.

Edukimi i hershëm është periudha më e rëndësishme, duke qenë vendimtare për mënyrën e zhvillimit të jetës së një fëmiu. Zhvillimi i shëndetshëm në vitet e para mundëson ndërtimin e blloqeve të trurit për arritje akademike, produktivitet ekonomik, qytetari përgjegjëse, jetë të shëndetshme dhe prindërim të suksesshëm për gjeneratën tjetër. Ekonomistë të shquar theksojnë se investimi në fëmijëri të hershme do t'i kthehet vendit në vlerë shumëfish më të madhe kur këta fëmijë do të hyjnë në tregun e punës. Gjithashtu edukimi i hershëm ka rëndësi të madhe në formimin e personalitetit të fëmijëve, themelet e të cilit vihen në 6 vitet e para të jetës. Andaj investimi në edukim parashkollor të institucionalizuar është jetike për zhvillimin e një shoqërie.

Edukimi parashkollor paraqet nivelin e parë të edukimit, më konkretisht moshën 0-6 vjeç gjatë të cilës fëmijët zhvillohen dhe edukohen në familjet e tyre ose/dhe në institucione parashkollore. Edukimi parashkollor organizohet në dy ndarje të grupmoshave: grupmosha 9 muaj-3 vjeç që përfshin çerdhen dhe grupmosha 3-6 vjeç që përfshin kopshtin, ndërsa të dyja funksionojnë brenda institucioneve parashkollore (IP).¹ Ky nivel i edukimit rregullohet me ligjin për edukimin parashkollor i hartuar në vitin 2006, i cili rregullon sistemin e edukimit parashkollor që i referohet edukimit të hershëm të fëmijëve si dhe edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta. Ky ligj i është nënshtruar procesit të rishikimit në vitin 2019, por nuk është aprovuar ende në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Me këtë ligj priten ndryshime në të mirë të fëmijëve, si njohja e statutit të organizimeve të tjera si ato me bazë në komunitet, por fatkeqësisht me po të njëjtin edukimi i hershëm nuk do të jetë i obliguar. Te gjeturat nga ky hulumtim tregojnë se nuk ka ende një kurrikulë për nivelin parashkollor 0-3 vjeç, por funksionojnë duke u bazuar në “Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç”. Procesi i hartimit të kësaj kurrikule paraqet një proces të tejzgjatur të filluar qysh në vitin 2011, i cili ka kaluar nëpër disa grupe punuese. Këto grupe punuese janë ndryshuar me ndryshimin e qeverive. Me ardhjen në detyrë, të tillat kanë hedhur poshtë draft kurrikulën e grupit paraprak. Kurrikula e fundit në përbërje të ekspertëve të edukimit të hershëm është paraparë të jetë praktike jo vetëm për edukatorët por edhe për prindërit dhe kujdestarët. Kjo kurrikulë ka qenë e

¹Në disa pjesë të raportit, Institucioneve Parashkollore (IP) i'u kemi referuar si kopshte dhe si çerdhe, edhe pse këto dy të fundit dallojnë nga njëra tjetra. Kjo për arsye që gjatë leximit fjalja të jetë e kuptueshme për të gjithë.

paraparë të implementohet në shtator, me fillimin e vitit shkollor 2019/2020, por sipas MASHT-it është konsideruar e pa pranueshme nga komuniteti i edukimit parashkollor dhe është hedhur poshtë. Si e tillë, edukimi parashkollor, gjegjësisht grupmosha 0-3 vjeç vazhdon të përballet me mungesë kurrikule, pasojat e së cilës po i mbartin më së shumti fëmijët.

Ky hulumtim ka përfshirë vetëm komunën e Prishtinës, për shkak të formave të ndryshme të organizimit të edukimit parashkollor. Kështu, të njëjtat do të mund të aplikohen edhe nga komuna të tjera. Edukimi parashkollor në Kosovë, duke përfshirë edhe komunën e Prishtinës, ka mungesë të institucioneve parashkollore dhe qasjes në edukimin e hershëm tek fëmijët. Fakti se në komunën e Prishtinës janë të përfshirë më pak se 10%, konkretisht vetëm 9.40% e fëmijëve në edukimin parashkollor, duhet dhënë alarmin për intervenim të menjëhershëm e sistematik në këtë fushë. Në Komunën e Prishtinës ekzistojnë forma të ndryshme të organizimit të Institucioneve Parashkollore, duke përfshirë ato publike, private, me bazë në komunitet dhe me partneritet publiko-privat. Nga diskutimet me prindër, më të preferuarat janë IP me bazë në komunitet me 46.48% e prindërve të anketuar. Kjo ndodhë për shkak se përderisa këto IP janë të funksionalizuara dhe menaxhuar nga vetë prindërit, ata e shohin pjesëmarrjen në vendimmarrje si një prej pikave më të forta. Duke qenë pjesë e procesit të rekrutimit të edukatorëve dhe pjesë e proceseve tjera operuese të kopshtit ata ndikojnë vazhdimisht në ngritjen e cilësisë, pajisjen me mjetet e duhura didaktike, argëtuese, logjistike, shtëpiake, cilësinë e ushqimit etj. Këto kopshte të inicuar nga komuniteti parashihen me nenin 7.1 të Ligjit mbi Edukimin e Hershëm. Sipas këtij neni kur në rrethin e vendbanimit të fëmijëve nuk ka institucione parashkollore, komuniteti ka të drejtë të vetorganizohet në përputhje me këtë ligj, për të ofruar shërbime të edukimit parashkollor. Një shembull tjetër i një bashkëpunimi mes institucioneve publike dhe private janë kopshtet me partneritet publiko-privat. Prindërit shprehen të kënaqur me këto kopshte përderisa nuk ekziston vetëm një trup menaxhues, por ndahet përgjegjësia mes komunës dhe entitetit tjetër privat. Përderisa komuna subvencionon gjysmën e shumës për pagesën e kopshtit për fëmijë, institucioni privat parashkollor ka përgjegjësi më të madhe, që ndikon më pas në rritjen e cilësisë. Sa i përket IP publike prindërit i shohin si më të sigurta dhe shumicës prej tyre i'u konvenon lokacioni. Megjithatë ata nuk janë të kënaqur me objektet e vjetra, lodrat e pamjaftueshme dhe një pjesë e tyre me moshën e vjetër të edukatoreve. Ndërsa kopshtet private nga perspektiva e prindërve që i dërgojnë fëmijët në këto IP, janë zgjedhje e duhur për shkak të afërsisë nga shtëpia dhe për shkak se ata e përballojnë një gjë të tillë financiarisht. Megjithatë shumica e objekteve të tilla ku funksionojnë këto IP nuk janë të dedikuara për IP por janë objekte ekzistuese, që sipas prindërve nuk janë shumë të përshtatshme për fëmijët. Rritja e numrit të kopshteve gjithashtu do të

fuqizonte pozitën e gruas në shoqëri, duke ditur se në shoqërinë tonë, barra e kujdesit ndaj fëmijëve dhe të moshuarve i'u bie grave. Kjo do t'iu sillte atyre mundësi për t'u përfshirë në tregun e punës, duke qenë se si pasojë ato bëjnë punë të pa paguar në shtëpi. Edhe sipas prindërve dhe intervistave me psikologë, përfshirja e grave në tregun e punës, përveq rritjes së nivelit të mirëqenies së tyre dhe familjes në përgjithësi, do të ndikonte pozitivisht në gjendjen e tyre emocionale, psikologjike dhe ndërpersonale.

Metodologjia

Për shkak të koncentrimit të organizimeve të ndryshme të IP në komunën e Prishtinës, ky hulumtim është përqendruar vetëm në komunë. Ky hulumtim, më specifikisht ka pasur për qëllim përgjigjen në pyetjet e mëposhtme hulumtuese:

1. Sa është i rëndësishëm edukimi i hershëm tek fëmijët?
2. Si e parasheh korniza ligjore në Kosovë edukimin e hershëm të institucionalizuar?
3. Cilat janë format e organizimit të edukimit parashkollor në komunën e Prishtinës?

a. Cilat institucionet parashkollore (IP) janë më të përshtatshme dhe më të përballueshme nga perspektiva e prindërve?

4. A do të ndikonte rritja e numrit të kopshteve në përmirësimin dhe fuqizimin e pozitës së grave në shoqëri?

Metodologjia e përdorur në këtë hulumtim është mikse (sasiore dhe cilësore). Fillimisht, ekipi hulumtues ka shqyrtuar literaturën ekzistuese rreth koncepteve dhe teorive përkatëse, sidomos ato që lidhen me edukimin e hershëm. Poashtu është shqyrtuar korniza ligjore dhe udhëzimet administrative në fuqi si dhe raporte të tjera kredibile në lidhje me edukimin e hershëm dhe organizimin e institucioneve parashkollore si në aspektin lokal ashtu edhe në atë qendror. Së dyti, janë realizuar 7 fokus grupe me 70 prindër të IP publike, private, me partneritet publiko-privat dhe me bazë në komunitet në komunën e Prishtinës. Fokus grupet kanë qenë gjithëpërfshirëse, me një përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave me 10-12

Metodologjia e përdorur në këtë hulumtim është mikse (sasiore dhe cilësore). Fillimisht, ekipi hulumtues ka shqyrtuar literaturën ekzistuese rreth koncepteve dhe teorive përkatëse, sidomos ato që lidhen me edukimin e hershëm. Poashtu është shqyrtuar korniza ligjore dhe udhëzimet administrative në fuqi si dhe raporte të tjera kredibile në lidhje me edukimin e hershëm dhe organizimin e institucioneve parashkollore si në aspektin lokal ashtu edhe në atë qendror. Së dyti, janë realizuar 7 fokus grupe me 70 prindër të IP publike, private, me partneritet publiko-privat dhe me bazë në komunitet në komunën e Prishtinës. Fokus grupet kanë qenë gjithëpërfshirëse, me një përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave me 10-12 pjesëmarrës për grup. Është paraparë që gjysma e tyre të realizohen në zona urbane dhe gjysma në zona rurale, por pasi që ka pasur mungesë të IP publike në zona rurale dhe ekiston vetëm një IP me partneritet publiko-privat, e ka bërë të pamundur një përfaqësim të kësaj mostre siç është planifikuar. Megjithatë diskutimet e tilla janë realizuar duke u përqendruar në lagje të ndryshme të kryeqytetit, në mënyrë që të arrihet një përfaqësim sa më gjithëpërfshirës. Si pjesë e fokus grupeve të realizuar me

prindër ka qenë edhe një pyetësor me pyetje konkrete rreth temës në fjalë, i cili mund të gjindet në Shtojcën 2. Të dhënat nga ky pyetësor janë analizuar përmes softuerit për analizë të të dhënave në shkenca shoqërore SPSS të cilat janë paraqitur në formë të grafeve dhe mund t'i gjeni të komentuara në raport. Më tutje, për të marrë më shumë informata rreth edukimit të hershëm dhe mënyrës së organizimit të institucioneve parashkollore, ekipi hulumtues ka realizuar 9 intervista të gjata me persona kompetent të fushës si: psikologë, ekspertë të edukimit të hershëm tek fëmijët, zyrtarë të departamentit parashkollor të Ministrisë së Arsimit, përfaqësues të organizatave për mbrojtjen dhe avokimin e të drejtave të fëmijëve si dhe përfaqësues të organizatave që avokojnë për barazi dhe të drejta të grave si dhe integrimin e tyre në shoqëri.

ZHVILLIMI I HERSHËM I FËMIJËVE; INVESTIMI NË EDUKIM, INVESTIM NË TË ARDHMEN

Zhvillimi i hershëm i fëmiut përfshin zhvillimin fizik, socio-emocional, kognitiv dhe motorik nga mosha 0-8 vjeç. Vitet e para të jetës janë kritike sepse kjo është koha gjatë të cilës truri zhvillohet me një shpejtësi shumë të madhe duke pasur një kapacitet të lartë për ndryshim.² Në këtë moshë vendosen themelet e krijimit të personalitetit, të personit/individit, pastaj krijimin e identitetit të vet personal, ngritjen e vetëbesimit, fillimin e zhvillimit të njohurive dhe shkathtësive. Sa më shumë që punojmë me fëmijët e moshës së hershme, aq më shumë kemi benefite kur ata fillojnë shkollën apo kur vazhdojnë shkollimin e mesëm të ulët apo të lartë. Duke iu referuar raportit të fundit të PISA-s, fëmijët e moshës 15 vjeçare të cilët kanë pasur sukses në këtë test, kanë marrë pjesë në edukimin e hershëm të institucionalizuar.³

Zhvillimi i trurit të fëmiut

Zhvillimi i shëndetshëm në vitet e para mundëson ndërtimin e blloqeve të trurit për arritje akademike, produktivitet ekonomik, qytetari përgjegjëse, jetë të shëndetshme dhe prindërim të suksesshëm për gjeneratën tjetër.⁴

Shkenca e thotë qartë: truri i fëmiut nuk lindë por krijohet.⁵ Në vitet e para të jetës më shumë se 1 milion lidhje nervore formohen çdo sekond. Procesi i krijimit të neuroneve fillon para lindjes, duke u reduktuar më pas përmes një procesi të quajtur “krasitje”. Ky proces i shpejtë ndodhë në vitet e para të lindjes, duke filluar me krijimin e lidhjeve shumë të thjeshta nervore, të ndjekura prej rrjeteve më komplekse. Koha në të cilën ndodhë ky krijim është gjenetike, por eksperiencat e hershme e përcaktojnë nëse këto rrjete nervore janë të forta apo të dobëta.⁶ Në këtë kohë konsiderohet që të paktën sinapsat (që janë hapësirat e komunikimit në mes të dy neuroneve) marrin hov të zhvillimit, 90% e zhvillimit të trurit përfundon në kuptimin e zhvillimit morfologjik por gjithashtu edhe në aspektin e funksioneve që kryen. Kështu që vetëm 10% e zhvillimit të trurit mbetet moshës pas 5 vjeçare që e bën kruciale këtë fazë të hershme të zhvillimit në cdo aspekt.⁷

Kapaciteti i trurit për ndryshime zvogëlohet me moshë. Truri është më fleksibil ose “plastik” në vitet e para të jetës për të njohur dhe pranuar një gamë të gjerë ambientesh dhe bashkëveprimesh. Por përderisa truri i pjekur bëhet më i specializuar për funksione më komplekse, është më pak i aftë për t'u riorganizuar dhe përshtatur me sfida të reja ose të papritura.⁸

²Early Child Development : A Powerful Equalizer – World Health Organization

³Intervista me Prof. Ass. Dr. Arlinda Beka, profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës "Hasan

⁴Three Core Concepts in Early Development, Harvard Center on the Developing Child

⁵<https://developingchild.harvard.edu/resources/three-core-concepts-in-early-development/>

⁶UNICEF Report, Early moments matter for every child

⁷https://www.unicef.org/publications/files/UNICEF_Early_Moments_Matter_for_Every_Child.pdf


⁸Three Core Concepts in Early Development, Center on the Developing Child, Harvard University.

<https://46y5eh11fhgw3ve3ytpwt9r-wpengine.netdna-ssl.com/wp-content/uploads/2007/03/InBrief-The-Science-of-Early-Childhood-Development2.pdf>

⁹Intervistë me psikologun Dr. Ass. Fitim Uka, Prishtinë, 2019

¹⁰The Science of Early Childhood Development, Center on the Developing Child, Harvard University

<https://developingchild.harvard.edu/resources/inbrief-science-of-ecd/>



Gjithashtu, edukimi i hershëm luan rol kyq në zhvillimin dhe formësimin e personalitetit të fëmijëve. Gjatë viteve të para, gjegjësisht në moshën 3-6 vjeç, fëmiju pëson një transformim të plotë në personalitetin e tij, nga zbulimi i vetvetes si subjekt deri në formimin e identitetit të tij.⁹

Edhe psikologët e intervistuar vënë në pah rëndësinë e viteve të para, përgjatë së cilave vendosen bazat për krijimin e personalitetit. Kjo ide sipas tyre nuk është diçka e re, duke qenë se ajo ka ekzistuar qysh prej qasjes psikanalitike të Frojdit, sipas të cilës vitet e para janë vendimtare në krijimin e personalitetit..¹⁰

Socializimi i fëmijëve, ndikimi i kopshteve

Komponenta prej së cilës fëmiju përfiton më së shumti nga edukimi i hershëm padyshim është socializimi. Edukimi i hershëm i mundëson fëmijëve sjellje prosociale, dëgjim aktiv, mësohet pritja e rendit, që sjellin zhvillim të aftësive vetë-rregulluese dhe më vonë suksesi akademik është i garantuar.¹¹



Meqenëse kopshtet i pranojnë fëmijët nga moshja 9 muajshe, është më e preferueshme që fëmijët të ndjekin kopshtet sepse përveq zhvillimit emocional e social, fëmija mësohet të pavarësohet dhe fillon të krijojë vetëbesim në mënyrë që të përballet më lehtë me çdo ndryshim në jetën e tij.¹²


Edhe prindërit, pjesëmarrës në fokus grupe ndajnë të njëjtin mendim, ku 88.73% e tyre pajtohen se angazhimi në IP ka pasur ndikim dukshëm pozitiv në socializimin e fëmijëve. Ndërsa 11.27% të tyre kanë deklaruar se fëmijët e tyre nuk kanë pësuar ndryshim në këtë drejtim.

⁹Bissoli, M. D. F. (2014). Development of Children's Personality: The role of early childhood education. *Psicologia em Estudo*, 19(4), 587-597.

¹⁰Intervista me psikologët Dr. Ass. Natyra Agani dhe me Dr. Ass. Fitim Uka, Prishtinë, 2019

¹¹Intervista me Dr. Ass. Fitim Uka, Psikolog, 2019

¹²Intervista me Prof. Ass. Dr. Arlinda Beka, profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", 2019



Gjatë diskutimeve me prindër, një prej arsyeve më të shpeshta që ata dërgojnë fëmijët në kopsht, përveq se nuk kanë zgjidhje tjetër, është socializimi. Sipas tyre sado inteligjent të jetë fëmiu kur nuk e ndjen veten pjesë të grupit ndikon negativisht në gjendjen emocionale të tyre. Në këtë mënyrë sipas tyre kopshti do të ndihmonte që fëmijët të mos jenë pasiv dhe të tërhequr.¹⁴

¹³Fokus grupi me prindër të IP privat, Prishtinë, 2019

¹⁴Fokus grupi me prindër të IP privat, Hajvali, Prishtinë, 2019

Rëndësia e lojës në zhvillimin e fëmijëve

Loja është thelbësore për zhvillimin e hershëm të fëmijës sepse kontribuon në mirëqenien kognitive, fizike, sociale dhe emocionale të fëmijëve dhe të rinjve. Përmes lojës fëmijët në një moshë shumë të hershme përfshihen dhe bashkëveprojnë me botën përreth tyre. Lojërat u mundësojnë fëmijëve të krijojnë dhe të eksplorojnë një botë që ata mund të zotërojnë, duke pushtuar frikën e tyre ndërsa praktikojnë role të rritura, ndonjëherë në bashkëpunim me fëmijë të tjerë ose kujdestarë të rritur.¹⁵ Në Kosovë, edhe pse përfshirja e fëmijëve të grupmoshës 5-6 vjeç në institucionet parashkollore është rritur, programi që u ofrohet fëmijëve në IP është shkollarizuar, duke mos ofruar të nxënit përmes lojës por detyrimin e një fëmiju 5 vjeçar për të qëndruar ulur duke plotësuar libra për një kohë të gjatë. Kjo sjell krijimin e një qasje apo një ndjenjë negative të fëmijës për shkollën.¹⁶



**Loja është thelbësore
për zhvillimin e hershëm të fëmijëve
sepse i'u mundëson atyre të përdorin
kreativitetin e tyre ndërsa zhvillojnë
imagjinatën, shkathtësitë dhe forcën fizike,
njohëse dhe emocionale duke qenë
e rëndësishme për zhvillimin
e shëndetshëm të trurit.¹⁷**

¹⁵Ginsburg, K. R. (2007). The importance of play in promoting healthy child development and maintaining strong parent-child bonds. *Pediatrics*, 119(1), 182-191.


¹⁶Intervista me Prof. Ass. Dr. Arlinda Beka, profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", 2019

¹⁷Ginsburg, K. R. (2007). The importance of play in promoting healthy child development and maintaining strong parent-child bonds. *Pediatrics*, 119(1), 182-191.

Investimi në edukim, investim në të ardhmen

“Investimi më i duhur që një qeveri e një vendi mund të bëjë është investimi në edukim të hershëm të fëmijëve, vlera e të cilit do të kthehet shumëfish më e madhe se sa që është investuar.”¹⁸ Ekonomisti James Heckman, fitues i çmimit Nobel ka mbështetur të njëjtën tezë: “Një dollar i shpenzuar në programe parashkollore gjeneron kthim më të madh të investimeve se investimi i njëjtë në programe shkollore.”¹⁹ (Grafiku 3) Në këtë graf theksohet rëndësia e investimit në nivelin e edukimit të hershëm, pra në kopshte dhe çerdhe, ku kthimi i investimeve në kapital njerëzor paraqitet të jetë më i larti. Me ritjen e moshës shkalla e kthimit të investimeve në kapital njerëzor pëson rënie.

Kosova ka nevojë për reformë të thellë të sistemit arsimor, duke rikthyer kurbën e investimit në drejtim të edukimit të hershëm dhe jo në edukim të lartë. Kjo pasiqë një bazament i mirëfilltë në edukim e hershëm garanton sukses në edukimin e lartë dhe asnjëherë e kundërta.²⁰



¹⁸Early Child Development : A Powerful Equalizer – World Health Organization, March 2007

¹⁹Investing in high-quality early childhood education and care (ECEC) - OECD

²⁰Intervista me psikologun Dr. Ass. Fitim Uka, Prishtinë, 2019

²¹Rates of return to human capital investment. Source: J. Heckman, "Policies to Foster Human Capital," Research in Economics 54, no. 1 (2000): 3-56.

KORNIZA LIGJORE E KOSOVËS LIDHUR ME EDUKIMIN E HERSHËM

Ky kapitull shqyrton mënyrën se si edukimi i hershëm i institucionalizuar është i rregulluar me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë.

Dokumentet dhe ligjet të cilat e rregullojnë Edukimin parashkollor në vend janë:

- ◆ Ligji Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor²²
- ◆ Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës²³
- ◆ Ligji nr. 04/ L-032 për Arsimin Parauniversitar në Kosovë²⁴
- ◆ Udhëzimi Administrativ 12/2006 Zbatimi i Standardeve të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë²⁵ që ka për qëllim zbatimin e Standardeve të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë, si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit.²⁶
- ◆ Udhëzimi Administrativ 19/2016 i cili ka për qëllim përfshirjen e të gjithë fëmijëve në edukim parashkollor. Përcakton moshat dhe ndan institucionet parashkollore në çerdhe dhe kopshte.²⁷
- ◆ Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH)²⁸
- ◆ Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë, 2017-2021²⁹
- ◆ Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar³⁰
- ◆ Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç³¹
- ◆ Kurrikula Bërthamë për klasat përgatitore dhe arsimin fillor³²
- ◆ Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç³³

Edukimi parashkollor është hallkë përbërëse e sistemit unik të edukimit dhe arsimit.³⁴ Edukimi parashkollor paraqet nivelin e parë të edukimit, më konkretisht moshën 0-6 gjatë të cilës fëmijët edukohen në familjet e tyre ose/dhe në institucione parashkollore.³⁵ Sipas udhëzimit administrativ mbi përfshirjen e fëmijëve në IP, edukimi parashkollor organizohet në dy ndarje të grupmoshave: grupmosha 9 muaj-3 vjeç që përfshin çerdhen dhe grupmosha 3-6 vjeç që përfshin kopshtin.³⁶ Pjesë e këtij niveli është edhe klasa përgatitore (mosha e fëmijëve 5-6 vjeç) që mund të organizohet në institucionet parashkollore ose/dhe në klasa përgatitore.³⁷ Kushtet, kriteret dhe standardet për fushëveprimin e insitucioneve parashkollore parashihen me Ligjin mbi edukimin parashkollor. I hartuar në vitin 2006, ligji mbi edukimin parashkollor rregullon sistemin e edukimit parashkollor që i referohet edukimit të hershëm të fëmijëve si dhe edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta.³⁸

²²Ligji Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor, 2006; <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/7-lep-ligji-mbi-eukimin-parashkollor.pdf>

²³Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës; <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/9ligji-i-arsimit-nekomuna2008-03-1068-al-ar-se-kom.pdf>

²⁴Ligji nr. 04/ L-032 për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, 2011. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

²⁵MASHT, UA 12/2006 Zbatimi i Standardeve të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë;

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ua-standardet.pdf>

²⁶Neni 1, UA-Zbatimi i Standardeve të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë

²⁷MASHT, UA 19/2016 Përfshirja e fëmijëve në Institucione parashkollore në Kosovë

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15178>

²⁸Qeveria e Kosovës, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021; http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

²⁹Plani Strategjik për Arsim në Kosovë 2017 – 2021; https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

³⁰MASHT, Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, 2016, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>

³¹MASHT, Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç, https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/kurrikula-e-edukimitparashkollor-ne-kosove-3-6-vjec_1.pdf

³²MASHT, Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, 0 deri 6 vjet, 2011, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>

³³Standardet e edukimit parashkollor; Neni 2, paragrafi 2.1, Ligji mbi Edukimin parashkollor

³⁴MASHT, Korniza kurrikulare, 2017 (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-kurrikulare-finale.pdf>)

³⁵MASHT, UA 19/2016 Përfshirja e fëmijëve në Institucione parashkollore në Kosovë <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15178>

³⁶MASHT, Korniza kurrikulare, 2017 (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-kurrikulare-finale.pdf>)

³⁷Ligji për Edukimin Parashkollor Nr. 02/L-52

Në Kosovë Ligji nr. 02/L-52 mbi Edukimin parashkollor rregullon edukimin parashkollor përmes normave institucionale.⁴¹ Ky ligj parasheh programet e duhura për edukim parashkollor në përputhje me kurrikulat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), standardet e edukimit parashkollor, mënyrën e financimit të institucioneve publike, atyre private dhe institucioneve tjera, stafin edukativ etj.⁴²

Ligji parasheh vijimin e edukimit parashkollor si vullnetar.³⁹ As me ligjin e ri, edukimi i hershëm nuk do të jetë obligativ.⁴⁰

Në strategjitë për zhvillimin e arsimit në Kosovë edukimi parashkollor është trajtuar në mënyrë të veçantë, përfshirë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021 dhe Planin Strategjik për Arsim në Kosovë (PSAK) 2017-2021. Megjithatë, përkundër përfshirjes së edukimit parashkollor në politikat zhvillimore, investimet në zhvillimin e këtij niveli vazhdojnë të mbesin mjaft të kufizuara.⁴³

SKZH synon që të rrisë përfshirjen e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe parafillor. Më konkretisht, ka për synim arritjen e përfshirjes universale në arsimin parafillor rritjen e numrit të fëmijëve që ndjekin arsim parashkollor për 5000 fëmijë në vit deri në vitin 2021. Kjo do të bëhet përmes rritjes së numrit të kopshteve publike dhe rritjes së përfshirjes përmes institucioneve private.⁴⁴ Objektivat që priten të përmbushen deri në vitin 2021 përfshijnë:

- ◆ Rritjen e numrit të kopshteve publike, me prioritet në komunat që nuk ka fare kopshte publike.
- ◆ Rritjen e përfshirjes së institucioneve private, përmes licencimit të institucioneve të reja dhe rilicencimit të institucioneve ekzistuese (rreth 124 kopshte).
- ◆ Investim në ngritje kapacitetesh për personelin mësimdhënës edhe në nivelin parashkollor dhe parafillor.⁴⁵

Në vitin 2014, për t'a rritur numrin e institucioneve parashkollore (IP) publike, MASHT poashtu ka fituar një fond prej 5.000.000 euro nga projektet e Bashkimit Evropian IPA për ndërtimin e institucioneve parashkollore publike. Me fondet e IPA-s dhe të MASHT, brenda dy viteve priten të ndertohen gjithsej 14 kopshte të reja publike në nivel të Kosovës.⁴⁶

Përmirësimi i suksesit të nxënësve mundëson zhvillimin e shkathtësive të fuqisë punëtore, e cila për një periudhë afatgjatë do të ndikojë në rritjen ekonomike të vendit.

³⁹ Ligji nr. 02/L-52 mbi edukimin e hershëm, Neni 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2401>

⁴⁰ Intervistë me një grua, pjesë përbërëse e grupit punues për hartimin e ligjit të ri mbi edukimin e hershëm, Prishtinë, 2019

⁴¹ Ligji nr. 02/L-52 mbi edukimin e hershëm, Qëllimet e edukimit parashkollor, Neni 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2401>

⁴² Ligji nr. 02/L-52 mbi edukimin e hershëm, Detyrat themelore, neni 9, Plan i dhe programi, neni 10, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2401>

⁴³ Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN – Edukimi parashkollor në Kosovë, hulumtim.

http://keen-ks.net/site/assets/files/1445/edukimi_parashkollor_ne_kosove_alb.pdf

⁴⁴ Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

⁴⁵ Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

⁴⁶ Intervistë me Laberi Luzha, udhëheqëse e divizionit për edukim parashkollor në MASHT, Prishtinë, 2019


Përkundër masave të parapara, deri në vitin 2018, nuk janë shënuar rezultate konkrete nga ana e autoriteteve në nivel qendror apo në nivel lokal. Përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor të institucionalizuar në Kosovë vazhdon të mbetet sfidë kur dihet se deri në vitin 2017,⁴⁷ sipas të dhënave nga Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA) janë vetëm 42 kopshte publike dhe 88 institucione private të licencuara, 5 prej të cilave janë me bazë në komunitet.⁴⁸

Edukimi parashkollor është përfshirë edhe në Planin Strategjik për Arsim në Kosovë i cili ka për qëllim të përcaktojë kahet e zhvillimit të sistemit të arsimit në periudhën 2017-2021, në mënyrë që arsimi të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Në kuadër të objektivave që parashihen të arrihen deri në vitin 2021 është edhe përfshirja e 20% të fëmijëve të moshës 0-5 në edukimin parashkollor dhe përfshirje të të gjithë fëmijëve të moshës 5 vjeçare në edukimin cilësor parafillor.⁴⁹

Edukimi parashkollor

Edukimi parashkollor paraqet nivelin e parë të edukimit, gjatë të cilit fëmijët edukohen në familjet e tyre ose/dhe në institucione parashkollore që nga mosha 0 - 3 dhe mosha 3-5 vjeç. Pjesë e këtij niveli është edhe klasa përgatitore (mosha e fëmijëve 5-6 vjeç) që mund të organizohet në institucionet parashkollore ose/dhe në klasa përgatitore.⁵⁰

Vëmendje e veçantë gjatë kësaj faze i kushtohet zhvillimit fizik nëpërmjet aktiviteteve fizike dhe përvojave që rrisin vetëdijen e fëmijëve për nevojën e mbrojtjes së mirëqenies së tyre fizike si dhe kujdesit për shëndetin dhe sigurinë.



⁴⁷Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN – Edukimi parashkollor në Kosovë, hulumtim.
http://keen-ks.net/site/assets/files/1445/edukimi_parashkollor_ne_kosove_alb.pdf

⁴⁸Institucionet shkollore publike: amë dhe paralele të ndara, Statistikat e Arsimit 2017/2018 <https://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>

⁴⁹Plani Strategjik për Arsim në Kosovë 2017 – 2021; https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

⁵⁰MASHT, Komiza kurrikulare (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/komiza-kurrikulare-finale.pdf>)



Edukimi parafillor – klasat përgatitore

Fëmijët në klasën përgatitore në shkollë dhe në institucionet parashkollore, ndihmohen për krijimin e përvojës edukative për ambientim/përshtatje në një formë të sistemuar të të nxënit nëpërmjet lojës-punës-mësimit.

Në klasën përgatitore (mosha 5-6 vjeç), fëmijët përveç shkathtësive e shprehive sociale, krijojnë bazat themelore të të nxënit, që përfaqësojnë elementet themelore të leximit, të shkrimit dhe të veprimeve me numra, me çka rritet gatishmëria e tyre për shkollim fillor dhe për jetë.⁵¹

⁵¹MASHT, Korniza kurrikulare <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-kurrikulare-finale.pdf>

Kurrikula për edukimin parashkollor

Sipas kornizës kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, edukimi parashkollor paraqet nivelin e parë të edukimit, që përfshin grupmoshën 0-5 vjeç . Ndërsa klasa përgatitore apo edukimi parafillor përfshin grupmoshën 5-6 vjeç.⁵²

“Edukimi parashkollor ende përballlet me mungesën e një kurrikule, proces ky i cili ka filluar të hartohet që nga viti 2011 nga grupe të ndryshme punuese por që nuk ka arritur të përfundohet ende.”

Projekti i parë edukativ i zhvilluar në nivele parashkollore në Kosovë është “Hap pas Hapi”, një metodologji për edukimin parashkollor që merret kryesisht me zhvillimin profesional të edukatoreve, me fokus të veçantë të nivelit parashkollor.⁵³ Nivelet formale të arsimit parauniversitar të Kosovës përputhen me Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Arsimit (KSNA), përpiluar nga UNESCO. Dallime ka në përbërjen e strukturës së Kurrikulës Bërthamë të KSNA 1, në kuadër të së cilës hyn klasa përgatitore, edhe pse është pjesë përbërëse e edukimit KSNA 0. Të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar janë të ndara në nënnivele formale, me emërtim - Shkallët Kryesore të Kurrikulës dhe kanë qëllime e funksione të caktuara. Kurrikulat Bërthamë hartohen për të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar duke përfshirë kurrikulën bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme (lindje-5 vjeç) dhe Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor.⁵⁴

Si bazë për edukimin parashkollor, që nga viti 2006 kanë shërbyer standardet e përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç dhe kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç (2006).⁵⁵ Që nga viti 2011 është hartuar dhe është duke u implementuar dokumenti i “Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç”.⁵⁶ Standardet krijohen që të rrisin cilësinë e përgjithshme të veprimtarisë edukative me fëmijët duke u përdorur për zhvillimin apo rishikimin e kurrikulës parashkollore por nuk e zëvendësojnë kurrikulën. Njëherit përdoren për përmirësimin dhe përgatitjen e motrave edukatore dhe edukatoreve parashkollore.⁵⁷

Kurrikula e fundit në përbërje të ekspertëve të edukimit të hershëm është paraparë të jetë praktike jo vetëm për edukatorët por edhe për prindërit dhe kujdestarët.⁵⁸ Kjo kurrikulë ka qenë e paraparë të implementohet në shtator me fillimin e vitit shkollor 2019/2020, por pasi që, sipas MASHT-it, është konsideruar e pa pranueshme nga komuniteti i edukimit parashkollor është hedhur poshtë.⁵⁹

⁵²Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-kurrikulare-finale.pdf>)

⁵³Intervista me Hana Zyfiu-Gashi, Menaxhere e Programit në KEC, Prishtinë, 2019

⁵⁴Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>

⁵⁵MASHT, Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-web_1.pdf

⁵⁶Intervista me Laberi Luzha, udhëheqëse e divizionit për edukim parashkollor në MASHT, 2019

⁵⁷MASHT, Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-web_1.pdf

⁵⁸Intervista me Prof. Ass. Dr. Arlinda Beka, profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2019

⁵⁹Intervista me Laberi Luzha, udhëheqëse e divizionit për edukim parashkollor në MASHT, Prishtinë, 2019

SISTEMI I EDUKIMIT PARASHKOLLOR NË KOMUNËN E PRISHTINËS

Ky kapitull prezanton format e ndryshme të organizimit të edukimit të hershëm të insitucionalizuar në komunën e Prishtinës si dhe rezultatet e dalura nga fokus grupet e organizuar me prindër rreth preferencave të tyre për IP të caktuara.

Sipas të dhënave statistikore të arsimit parauniversitar publikuar nga MASHT, në vitin shkollor 2017/2018⁶⁰ në Kosovë pjesë e arsimit parafillor kanë qenë 24002 fëmijë (mosha 5-6), ndërsa në vitin 2018/2019 ky numër është zvogëluar në 23749 fëmijë. Në arsimin parashkollor është shënuar rritje e numrit të fëmijëve nga 6636 në vitin 2017/2018 në 8335 në vitin 2018/2019.⁶¹

Komuna e Prishtinës si kryeqendër e Kosovës është komuna më e madhe në Republikën e Kosovës dhe qendra më e rëndësishme administrative e vendit. Sipas regjistrimit të popullsisë në Kosovë më 2011, komuna e Prishtinës ka 198,897 banorë.⁶² Sipas raportit “Statistikat e arsimit 2018/2019” të publikuar nga MASHT dhe ASK, në komunën e Prishtinës janë gjithsej 1197 fëmijë të kyqur në edukimin parashkollor. Ndërsa në nivelin parafillor janë të përfshirë 2587 fëmijë. Niveli parafillor është i organizuar në institucione parashkollore apo në shkolla fillore dhe të mesme të ulëta.⁶³ Megjithatë, ende mbetet shqetësuese përfshirja në nivelin parashkollor, në veçanti në nivelin 0-3, që është larg përmbushjes së standardeve evropiane të pjesëmarrjes.⁶⁴

Sfidat kryesore të identifikuara në Planin Zhvillimor të Arsimit në Prishtinë 2018-2022 janë:

- ◆ Mungesa e kapaciteteve infrastrukturore dhe materialeve.
- ◆ Fondet e pamjaftueshme për rritjen e përfshirjes dhe cilësisë në EPSH për fëmijët 2-5 vjeç.
- ◆ Mungesa e programeve të trajnimit në fushën e edukimit parashkollor.
- ◆ Mungesa e zbatimit të metodologjive pedagogjike për edukim parashkollor.
- ◆ Mungesa e shërbimeve shëndetësore-psikopedagogjike.
- ◆ Mungesa e zbatimit të standardeve të organizimit të punës edukative-arsimore në IP-ve⁶⁵

Edukimi parashkollor në Kosovë, duke përfshirë edhe komunën e Prishtinës, ka mungesë të institucioneve parashkollore dhe qasjes në edukimin e hershëm tek fëmijët. Fakti se në komunën e Prishtinës janë të përfshirë më pak se 10%, konkretisht vetëm 9.40% e fëmijëve në edukimin parashkollor, duhet dhënë alarmin për intervenim të menjëhershëm e sistematik në këtë fushë.⁶⁶

⁶⁰MASHT, Shënime statistikore Arsimit parauniversitar 2017/2018 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/03/shenime-statistikore-2017-18-arsimi-parauniversitar.pdf>

⁶¹MASHT, Shënime statistikore Arsimit parauniversitar 2018/2019 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/02/shenime-statistikore-2018-19-arsimi-parauniversitar.pdf>

⁶²Ajencia e Statistikave të Kosovës – Regjistrimi i popullsisë në Kosovë 2011 (<http://ask.rks-gov.net/>).

⁶³MASHT dhe ASK, “Statistikat e arsimit në Kosovë 2018/2019” <http://ask.rks-gov.net/media/5055/statistikat-e-arsimit-2018-2019.pdf>

⁶⁴MASHT, Plani strategjik i arsimit 2017-2021

<https://kk-arkiva.rks-gov.net/kacanj/getattachment/82795cf5-3b62-48b1-9355-7c32e1e03187/PLANI-STRATEGJIK-I-ARSIMIT-NE-KOSOVE-2017-2021.aspx>

⁶⁵Plani Zhvillimor i Arsimit në Prishtinë 2018-2022 <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/Plani-Zhvillimor-i-Arsimit-PRISHTINE-ALB.pdf>

⁶⁶Plani Zhvillimor i Arsimit në Prishtinë 2018-2022 (<http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/Plani-Zhvillimor-i-Arsimit-PRISHTINE-ALB.pdf>)

Financimi i qëndrueshëm i arsimit në Komunën e Prishtinës bëhet përmes rishikimit të përbashkët vjetor ku mobilizohen dhe konsolidohen të gjitha fondet e mundshme për financim të arsimit në komunë. Këtu përfshihen granti komunal nga buxheti nacional (subvencionet), mjetet vetanake të komunës, donacionet e brendshme e të jashtme, projektet, kontributet e komunitetit, partneritetet publiko private, nismat me bazë në komunitet, e të tjera.⁶⁷

Format e organizimit të edukimit parashkollor

Institucionet parashkollore publike financohen nga Komuna, nën mbikqyrjen e Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) dhe funksionojnë sipas kurrikulave dhe udhëzimeve të MASHT-it.⁶⁸ Nga buxheti i komunës sigurohen fondet për mirëmbajtjen dhe investimin në pajisjet e institucionit. Staf i çerdheve publike konsiderohet si pjesë e shërbyesve civil.⁷⁰ Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës rregullon organizimin e institucioneve arsimore publike dhe ofrimin e arsimit publik në nivelet arsimore parashkollore, fillore, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë në komunat e Republikës së Kosovës.⁷¹ Ky ligj definon qartë kompetencat e Komunave në ndërtimin e objekteve shkollore, regjistrimin dhe pranimin e nxënësve, pranimin e mësimdhënësve etj.⁷² Në komunën e Prishtinës operojnë 8 Institucione Parashkollore publike, ku vijnë edukimin parashkollor dhe parafillor 1619 fëmijë.⁷³

Institucionet parashkollore private mund të krijohen prej personave juridik dhe licencohen në bazë të udhëzimit administrativ për licencimin dhe regjistrimin e institucioneve edukative-arsimore parashkollore private.⁷⁴ Këto institucione duhet të ofrojnë objekte edukativo-arsimore të mjaftueshme (2 m² /1 fëmijë), pajisje të nevojshme edukative, lokale përcjellëse, oborr dhe mjedisi i shëndoshë dhe të sigurt për fëmijët, mjedise të brendshme të dedikuara për aktivitete. Ato mundësojnë veprimtari që zhvillohen individualisht, në grup të vogël dhe me të gjithë grupin e fëmijëve, në përshtatje me shumëllojshmërinë e veprimtarive edukative që përmban kurrikula e edukimit parashkollor. Në komunën e Prishtinës veprojnë 40 institucione parashkollore private të licencuara me gjithsej 1702 fëmijë.⁷⁵

Qendrat me bazë në komunitet janë forma të organizimit të edukimit parashkollor, të cilat u ndërtuan kryesisht në zonat rurale nëpërmjet projektit “Qendrat me bazë në komunitet” që nga viti 2001. Këto qendra kanë përfshirë në programet e tyre fëmijët që jetojnë në zona rurale që nuk mund të jenë pjesë e programeve me qëndrim tërë ditë.⁷⁶ Qendrat e tilla në Ligjin mbi Edukimin parashkollor njihen si Institucione të tjera parashkollore.⁷⁷

⁶⁷Plani Zhvillimor i Arsimit në Prishtinë 2018-2022, fq. 15 <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/Plani-Zhvillimor-i-Arsimit-PRISHTINE-ALB.pdf>

⁶⁸Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 02/L-52 MBI EDUKIMIN PARASHKOLLOR, Neni 41, 46 http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L52_al.pdf

⁶⁹Po aty, Neni 18

⁷⁰Po aty, Neni 28, pika 28.11

⁷¹Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Neni 1 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2543>

⁷²Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Neni 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2543>

⁷³Plani Zhvillimor i Arsimit në Prishtinë 2018-2022 <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/Plani-Zhvillimor-i-Arsimit-PRISHTINE-ALB.pdf>

⁷⁴Udhëzimi administrativ për licencimin dhe regjistrimin e institucioneve edukative-arsimore parashkollore, 2011 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8054>

⁷⁵MASHT, Institucionet e Licencuara Edukative Arsimore Parashkollore, 2018 <https://masht.rks-gov.net/divizioni-per-arsim-privat-parauuniversitar>

⁷⁶Rozafa Shala, Alternativat e metodologjive të edukimit parashkollor dhe aplikimi i tyre në Kosovë, Punim i doktoratës, Tiranë, 2017.

⁷⁷<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/07/Rozafa-Shala-Disertacioni-Finale-25.12.2017.pdf>

⁷⁸Ligji nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor, neni 1, paragrafi 4

Institucionet parashkollore me partneritet publiko-privat rregullohen në bazë të ligjit për partneritet publiko-privat.⁷⁸ Në komunën e Prishtinës funksionon Institucioni Parashkollor “Fillesa”, si i vetmi IP me Partneritet Publiko-Privat me 131 fëmijë të përfshirë në edukim të hershëm.

Kopshtet me bazë në komunitet janë një organizim alternativ i institucioneve parashkollore. Ligji mbi edukimin parashkollor parasheh që kur në rrethin e vendbanimit të fëmijëve nuk ka institucione parashkollore, komuniteti ka të drejtë të vetë organizohet në përputhje me këtë ligj, për të ofruar shërbime të edukimit parashkollor. Në mbështetje të këtyre organizimeve të komunitetit, institucionet përgjegjëse të edukimit parashkollor të komunës përkatëse, duhet të synojnë të gjejnë mundësi për të përkrahur këto iniciativa. Përkrahja duhet të jetë në përputhje me këtë ligj dhe aktet tjera nënligjore.⁷⁹ Megjithatë, në ligjin ekzistues mbi edukimin parashkollor këto kopshte nuk cilësohen si institucionet tjera parashkollore por njihen si qendra me bazë në komunitet.⁸⁰ Si e tillë, këto kopshte licencohen nga MASHT si IP private, ndërsa nuk operojnë si të tilla. Por me ligjin e ri, pas shumë insistimeve nga drejtoret e kopshteve me bazë në komunitet, këtyre kopshteve do t'u njihet statuti i tyre si IP me bazë në komunitet.⁸¹

Ekziston vetëm një udhëzim administrativ, që rregullon më në detaje fushën e organizimit dhe veprimtarisë së kopshteve me bazë në komunitet. Ky udhëzim administrativ i vitit 2007 parasheh kushtet dhe mundësitë e përkrahjes së edukimit parashkollor nga komuniteti si dhe përcakton kushtet për bashkëpunimin në mes komunitetit dhe komunës që bashkë të sigurojnë kushte për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore si dhe përcakton mirëvajtjen e punëve në këto institucione.⁸² Ky lloj i organizimit ka filluar të zbatohet për herë të parë në Komunën e Prishtinës.

Kopshtet me bazë në komunitet themelohen dhe funksionojnë përmes bordit të prindërve të cilët zgjedhin një drejtues të kopshtit nga radhët e komunitetit. Komuna zakonisht siguron hapësirën, ndërsa prindërit menaxhojnë kopshtin. Të tilla kopshte paraqesin një mundësi të re për të rritur numrin e fëmijëve në edukimin parashkollor duke shmangur kufizimet buxhetore të autoriteteve qendrore dhe lokale për institucione parashkollore.⁸³ Këto kopshte janë të pavarura në aspektin financiar sepse financohen nga komuniteti, por në anën tjetër udhëheqësia e institucionit parashkollor, që në këto raste është drejtori apo drejtoresha nuk është faktor vendimmarrës pa bashkëpunimin me komunitetin e prindërve. Kjo i fuqizon ato për dallim prej kopshteve publike, që faktor vendimmarrës është DKA-ja apo edhe ministria ndonjëherë që shpesh sjellë edhe implikime.⁸⁴

⁷⁸Plani Zhvillimor i Arsimit në Prishtinë 2018-2022 <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/Plani-Zhvillimor-i-Arsimit-PRISHTINE-ALB.pdf>

⁷⁹Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 02/L-52 MBI EDUKIMIN PARASHKOLLOR, Neni 7, Pika 7.1 http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L52_al.pdf

⁸⁰Ligji nr. 02/L-52 mbi edukimin e hershëm, Neni 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2401>

⁸¹Intervistë me një grua, pjesë përbërëse e grupit punues për hartimin e ligjit të ri mbi edukimin e hershëm, Prishtinë, 2019


⁸²Udhëzimi administrativ 42/2007 - Kushtet dhe mundësitë e përkrahjes së edukimit parashkollor nga komuniteti

⁸³KEEN, Edukimi parashkollor në Kosovë http://keen-ks.net/site/assets/files/1445/edukimi_parashkollor_ne_kosove_alb.pdf

⁸⁴Intervista me Prof. Asr. Dr. Arlinda Beka, profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2019

Preferencat e prindërve, pse angazhimi i komunitetit e bën diferencën?

Gjatë diskutimeve dhe anketës së realizuar me prindër në komunën e Prishtinës, 46.48% e tyre preferojnë që fëmijët e tyre të vijnë IP me bazë në komunitet. Këtë preferencë e ndajnë prindërit, fëmijët e të cilëve ndjekin kopshtet me bazë në komunitet (57.58%), IP publike (27.27%) dhe IP private (15.15%).



Duke qenë pjesë e vendimarrjes ata zgjedhin më të mirën për fëmijët e tyre dhe për këtë arsye ata janë të kënaqur me funksionimin e tyre.⁸⁵

Një prind nga fokus grupi i IP me partneritet publiko-privat është shprehur se është interesuar për IP me bazë në komunitet por nuk do t'a dërgonte fëmijën në një IP statuti i të cilit nuk njihet sipas ligjit.⁸⁶

Prindërit që i dërgojnë fëmijët në kopshte me bazë në komunitet janë më të kënaqur për shkak se ndihen pjesë e funksionimit të këtyre kopshteve.

"Jam interesuar për kopshtet me bazë në komunitet, por nuk do t'a dërgoja fëmijë në një kopsht statuti i të cilit nuk njihet me ligj".⁸⁷

⁸⁵Fokus grupi me prindër të IP me bazë në komunitet, Prishtinë, 2019

⁸⁶Fokus grupi me prindër të IP me partneritet publiko-privat, Prishtinë, 2019

⁸⁷Prind burrë, pjesë e fokus grupit të realizuar me IP me partneritet publiko-privat, Prishtinë, 2019

Në komunën e Prishtinës deri më tani janë hapur 10 kopshte të tilla: “Botanika” në Mati 1, “Ngjyrat” në Hajvali, “Shtëpia Magjike” në fshatin Besi, “Shkronjat” në Arbëri, “Zogjtë” në Sofali, “Milingonat” në Kodrën e Trimave dhe “Ketrushët” në lagjen Tophane. Në të njëjtin model të funksionimit ka kaluar edhe SOS-Kopshti në lagjen Velania. Në këto Institucione Parashkollore me bazë në komunitet ndjekin edukimin e hershëm 406 fëmijë, duke mos përfshirë kopshtin “Milingonat” që ka filluar punën në fillim të vitit 2019 dhe ka rreth 160 fëmijë⁸⁸, kopshtin “Ketrushët” i cili është hapur në nëntor të vitit 2019 me kapacitet për 80 fëmijë të kësaj lagje, kopshti “Cicërimat” në lagjen Kalabria me kapacitet për 75 fëmijë dhe kopshti “Yllkat” me kapacitet prej 260 fëmijëve, duke qenë kështu kopshti më i madh në Kosovë me 2000m².

Arsyeja më e shpeshtë pse prindërit me të cilët janë mbajtur fokus grupet kanë vendosur t'i dërgojnë fëmijët në IP publike, ka qenë çmimi, lokacioni i përshtatshëm dhe ndjenja e sigurisë që këto IP ofrojnë. Për një nënë të papunësuar, e cila nuk kërkon punë për shkak se kujdeset për fëmijun me autizëm, ndërsa fëmijun tjetër e dërgon në IP publik vetëm për shkak të çmimit të përballueshëm.⁸⁹ Një pjesëmarrëse e fokus grupit me prindër të IP private ndan eksperiencën e saj duke thënë se ka aplikuar në shtatë IP publike në kryeqytet për të dërguar fëmijun dhe janë refuzuar me arsyetimin se nuk i kanë plotësuar kushtet.



*“Duhet të njohësh patjetër dikë për të
pasur mundësi t'a dërgosh fëmijun në
kopsht publik.”⁹⁰*

Prind grua, Prishtinë, 2019

Prindërit, sidomos të IP private mendojnë se kushtet në IP publike janë më të dobëta dhe objektet janë të vjetra. Megjithatë objektet e IP publike janë të destinuara për kopshte, në krahasim me ato private të cilat janë improvizim i atyre ekzistuese. Një pjesë e tyre deklarojnë se kanë pasur eksperiencë me IP publike dhe nuk janë ndarë të kënaqur, përveq tjerash edhe në rastet kur fëmijë i tyre sëmuret dhe trajtohet me antibiotik nuk pranohet prej IP publike, që i'u kushton prindërve me një javë pushim nga puna. Për këtë arsye ata zgjedhin kopshtet private. Një pakënaqësi tjetër në lidhje me IP publike është pushimi veror, ku shumë prindër detyrohen t'i dërgojnë fëmijët tek gjyshërit apo në kopshte private gjatë 2 muajve të verës kur IP publike nuk punojnë.⁹¹

⁸⁸Plani Zhvillimor i Arsimit në Prishtinë 2018-2022 <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/Plani-Zhvillimor-i-Arsimit-PRISHTINE-ALB.pdf>


⁸⁹Fokus grupi me prindër të IP me bazë në komunitet, Prishtinë, 2019

⁹⁰Fokus grup me prindër të IP private, Prishtinë, 2019

⁹¹Fokus grup me prindër të IP publike, Prishtinë, 2019


Edukimi i hershëm nga perspektiva e prindërve

Në fokus grupet e organizuara me prindër kemi paraparë përfaqësim të barabartë të të gjitha formave të organizimeve që ekzistojnë në komunën e Prishtinës. Por, pasi që deri më tani ekziston vetëm një IP me partneritet publiko-privat është përfaqësuar me 16.67% të prindërve të cilët i dërgojnë fëmijët në këtë IP. Ndërsa pjesa tjetër e prindërve përfaqësohet në mënyrë të barabartë me nga 27.78% që i dërgojnë fëmijët e tyre në IP private, publike dhe me bazë në komunitet. (Grafiku 5)



Sa i përket numrit të fëmijëve që vijnë në edukimin e hershëm të institucionalizuar, shumica e tyre (73.61%) kanë vetëm një fëmijë duke ndjekur IP, ndërsa pjesa tjetër (26.39%) kanë më shumë fëmijë në IP (Grafiku 6). Pjesa më e madhe e fëmijëve të prindërve të anketuar gjatë fokus grupeve janë të moshës 4-5 (45.83%) dhe 3-4 vjeçare (40.28%). Vetëm 6.94% të tyre janë të moshës nën 1 vjeç, 13.89% i takojnë moshës 1-2 vjeçare dhe 18.06% 2-3 vjeç. (Grafiku 6)






Pjesa më e madhe e prindërve (56.34%) paguajnë 50-100 euro në muaj nga buxheti i përgjithshëm familjar për shpenzime të IP për fëmijun. Këtu bëjnë pjesë vetëm prindërit që e kanë një fëmijë duke ndjekur IP. Më pas, 15.49% e tyre paguajnë 100-150 euro, ndërsa 5.63% e prindërve që paguajnë 150-200 euro në muaj, janë prindërit që dërgojnë 2 fëmijë në IP. Vetëm 11.27% e prindërve shpenzojnë më pak se 50 euro për të paguar IP dhe pjesa më e madhe e tyre (87.5%) kanë vetëm një fëmijë. (Grafiku 7)



Prindërit me shpenzime mujore të dedikuara për kopshte që kapin vlerën më pak se 50 euro kanë fokusin në kopshte publike, me partneritet publiko-privat dhe me bazë në komunitet.



Të ardhurat mujore të shumicës së prindërve të anketuar gjatë fokus grupeve (54.41%) kanë qenë 500-1000 euro, ndërsa në mënyrë pothuajse të barabartë kanë qenë prindërit më të ardhura mujore më pak se 500 euro dhe më shumë se 1000 euro. (Grafiku 8)

Pjesa më e madhe e prindërve në komunën e Prishtinës (62.50%) janë të kënaqur me përgatitjet e personelit mësimor në kopshtin ku ata dërgojnë fëmijët e tyre. Vetëm 4.17% e tyre shprehen të pakënaqur me përgatitjet profesionale të stafit mësimor në kopshtet përkatëse. (Grafiku 9)

Çmimi i përballueshëm gjithashtu ishte një prej arsyeve që prindërit i dërgojnë fëmijët në kopshte publike, me partneritet publiko-privat dhe me bazë në komunitet si kopshtet më të përballueshme ekonomikisht për buxhetin e familjes.




Shumë të kënaqur

Të kënaqur

Të pakënaqur

Grafiku 9. Sa janë të kënaqur prindërit me përgatitjet profesionale të stafit mësimor?





Pjesa më e madhe e prindërve që janë shprehur si shumë të kënaqur me përgatitjet profesionale të stafit mësimor në IP përfshijnë prindër që i dërgojnë fëmijët në IP private (37.78%), me bazë në komunitet (31.11%) dhe me partneritet publiko-privat (16.67). Ndërsa pakënaqësia më e madhe është drejt personelit mësimor në IP publike me 66.67% të prindërve të pakënaqur që dërgojnë fëmijët në këto IP. Arsyeja kryesore e pakënaqësisë me edukatore në IP publike është moshë e tyre. Kjo pakënaqësi vie sidomos nga prindërit e IP private, por që i kanë pasur fëmijët më herët në IP publike.

“Edukatoret në IP publike janë më në moshë dhe nuk kanë çfarë të ofrojnë më për fëmijët.”⁹²

*Prind burrë,
Prishtinë, 2019*


⁹²Fokus grup me prindër të IP private, Prishtinë, 2019



Grafiku 10. Ku i adresojnë prindërit ankesat dhe a merren parasysh?


Sa i përket adresimit të ankesave, 85.71% e prindërve i adresojnë ato tek edukatorja, ankesa merret parasysh, ndërsa 12.86% e prindërve të anketuar i adresojnë ankesat tek drejtori, ankesa merret parasysh. Edhe gjatë diskutimeve nuk ka pasur vërejtje sa i përket adresimit të ankesave. Prindërit kanë vënë në pah lidhjen më të madhe të tyre me edukatoren pasi që janë ato që e kanë nën përkujdesje gjatë gjithë kohës fëmijun e tyre. Ndërsa vetëm në raste të ankesave potenciale ndaj edukatoreve ata kanë tendencë të drejtohen tek drejtoresha.⁹³ (Grafiku 10)

Shumica e prindërve (71.43%) janë shprehur se fëmijët e tyre nuk janë ngacmuar ndonjëherë brenda ambienteve të kopshtit, nga fëmijët e tjerë apo mësueset. Ndërsa 18.57% e tyre nuk kanë informatë nëse një fenomen i tillë ka ndodhur apo jo. Vetëm 10% e prindërve kanë pohuar se fëmijët e tyre janë ngacmuar në kopsht (Grafiku 11). Në 10% të prindërve që deklarojnë se fëmijët e tyre janë ngacmuar në IP, pjesa më e madhe (85.71%) i përkasin prindërve, fëmijët e të cilëve ndjekin IP publike.




⁹³Fokus grupet e realizuara me prindër, Prishtinë, 2019


Por nga këta të fundit, të gjithë janë shprehur se fëmijët janë ngacmuar nga fëmijët e tjerë në kopsht dhe jo nga mësueset. (Grafiku 12)



Sa i përket lodrave të ofruara në kopsht dhe hapësirave rekreative, pjesa më e madhe e prindërve janë shprehur si shumë të kënaqur (52.78%) me paisjet e argëtimit dhe hapësirat rekreative të ofruara në IP. Ndërsa, 6.94% e prindërve janë të pakënaqur me lodrat dhe hapësirat rekreative që ofrohen në IP përkatëse. (Grafiku 14)



Gjatë diskutimeve me prindër, pjesa më e madhe e tyre janë shprehur shumë të kënaqur me paisjet e argëtimit dhe hapësirat rekreative që ofrohen në IP private, me bazë në komunitet dhe me partneritet publiko-privat. Ndërsa pakënaqësia më e madhe sa i përket lodrave dhe hapësirës më të madhe ekziston tek IP publike. Sipas një nëne, fëmiju i së cilës ndjek IP publik, klasat janë shumë të vogla për një numër të madh si ai aktual i fëmijëve. Sipas saj në këtë mënyrë ata nuk mund t'a shprehin veten sepse nuk kanë kohën dhe hapësirën e mjaftueshme.⁹⁴ Përveq hapësirave rekreative, sipas prindërve edhe mënyra se si zhvillohet qëndrimi gjithë-ditor në IP është shpesh mjaft e mërzitshme për fëmijët. Kjo për shkak se sipas një prindi të një prej IP publike edhe mjetet didaktike si ngjyrat apo lapsat me ngjyra janë të thyer dhe në mungesë. Ndërsa fëmijët shfrytëzojnë pjesën e jashtme të IP shumë rrallë.⁹⁵



⁹⁴Fokus grup me prindër të IP publik, Prishtinë, 2019

⁹⁵Fokus grup me prindër të IP publik, Prishtinë, 2019

Prej prindërve pjesëmarrës në hulumtim, 51.39% e tyre janë shprehur shumë të kënaqur me ushqimin që ofron kopshti, ndërsa 47.22% janë të kënaqur duke qenë të mendimit se kopshti ofron meny të larmishme. Nga fokus grupet e realizuara, ushqimi hyn në një prej arsyeve që prindërit i dërgojnë fëmijët në një IP specifik. Kështu, një prind është shprehur se ka vendosur t'a dërgojë fëmijun në IP publik vetëm për shkak të ushqimit sepse e di që është i kontrolluar.⁹⁶ Në përgjithësi prindërit nuk shprehen të interesuar për të parë personalisht çfarë ushqimi i'u ofrohet fëmijëve, por zakonisht e marrin si informatë nga fëmijët vetë. Kjo i'u sjellë atyre përshtypjen e mirë apo të kundërtën rreth ushqimit.

Investimi në edukim të hershëm për fuqizim të grave

*"Rritja e numrit të kopshteve do të ndikonte që gratë të cilat bëjnë punë të pa paguar në shtëpi të kenë kohën për të kërkuar punë dhe të rrisin gjatë të përfshihen në tregun e punës."*⁹⁷



Në shumicën e kulturave, grave u caktohen detyrat dhe përgjegjësitë tradicionale gjinore të punës së kujdesit pa pagesë. Edhe në Kosovë shkalla e punës së papaguar të gratë është e lartë. Kujdesi pa pagesë mund të ndikojë negativisht në nivelin e arsimit të tyre, në pjesëmarrjen e tyre në fuqinë punëtore, në përfshirjen politike si dhe në nivelet e varfërisë gjatë jetës.⁹⁸ Sipas një kalkulimi të bërë nga IDRA Research & Consulting Kosova, puna e papaguar e grave në Kosovë për kohën e shpenzuar në kujdes të shtëpisë dhe familjes është 2 miliardë e 616 milionë euro.⁹⁹

Duke qenë se 13.7% e grave janë të punësuar, niveli i papunësisë është alarmant me 32.7%. Në raportin "Kush Kujdeset" të realizuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës, 88% e grave të papuna, janë shprehur se do të kërkonin punë në qoftë se mund të gjenin kujdes për fëmijët e tyre.¹⁰¹

⁹⁶Fokus grupi me prindër të IP publik, Prishtinë, 2019

⁹⁷Intervista me përfaqësues nga Rrjeti i Grave të Kosovës, Prishtinë, 2019

⁹⁸Raporti "Kush kujdeset? Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë.", RrGK, Prishtinë, 2016

⁹⁹IDRA Research & Consulting - Kosova

¹⁰⁰Ajencia e statistikave të Kosovës <http://ask.rks-gov.net/media/5060/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-tm2-2019.pdf>

¹⁰¹Raporti "Kush kujdeset? Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë.", Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), Prishtinë, 2016

Me këtë pajtohen edhe gratë dhe burrat që ishin pjesë e diskutimeve. Ata deklaruan se nëse në afërsi nuk do të kishte kopshte, gratë do të ishin ato që do të duhej të sakrifikonin karrierën e tyre për t'u kujdesur për fëmijët. Një nevojë e madhe është shtruar për kopshte për fëmijë me zhvillim të vonshëm, nga një nënë e cila si pasojë e mungesës së institucioneve të tilla, detyrohet të kujdeset për fëmijun në shtëpi. Si pasojë ajo është deklaruar se nuk është në kërkim të ndonjë punë.¹⁰²


Në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit (SKZH) 2016-2021 theksohet gjithashtu se përfshirja e fëmijëve në aktivitete parashkollë do të kishte efekt pozitiv në ritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, teksa mungesa e IP-ve bën që ato të detyrohen të mbesin në shtëpi.¹⁰³

Pjesë e pyetësorit dhe diskutimeve me prindër ishte edhe fuqizimi i pozitës së grave përmes ofrimit të kushteve për edukim parashkollor për fëmijët. Shumica e prindërve (95.83%) mendojnë se pozita e gruas do të përmirësohej nëse ato do të kishin mundësi t'i dërgonin fëmijët në IP. Kjo do të thotë që grave do t'iu ofroheshin kushte për të ndjekur karrierën e tyre dhe për të pasur një jetesë me një nivel më të lartë të mirëqenies.

Pajtohem

Nuk pajtohem
me këtë hipotezë

Nuk e di



Grafiku 16. Pozita e gruas në shoqëri do të fuqizohej me ritjen e numrit të kopshteve

Përveq kësaj, kjo do ti kontribonte edhe aspektit emocional dhe psikologjik të grave.

*Mos-kontributi material për familjen, heqja dorë nga puna për shkak të kujdesit ndaj fëmijut shpesh i bën gratë të ndihen të padobishme dhe me tendencë drejt depresionit.*¹⁰⁴

¹⁰² Fokus grupi me prindër IP publik, Prishtinë, 2019

¹⁰³ Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

¹⁰⁴ Intervista me Dr. Ass. Natyra Agani, ligjeruese në Departamentin e Psikologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Specialiste e Psikologjisë Klinike dhe Psikoterapise, Prishtinë, 2019

Gjithashtu, pamundësia e arritjes së qëllimeve dhe objektivave në karrierë shkakton disbalanc emocional tek gratë, duke sjellur një nivel të shtuar të stresit dhe prishje të raporteve sociale dhe ndërpersonale me të tjerët.¹⁰⁵ Një burrë, pjesë e fokus grupit është shprehur se e ka vërejtur gjendjen e gruas së tij gjatë gjatë gjashtë muajve të parë të pushimit të lehonisë, se ajo është mbyllur në vete dhe është izoluar.¹⁰⁶ Pjesa më e madhe e tyre janë shprehur se punësimi i gruas në familje ka ndikime shumëdimensionale.



“Kontributi financiar i gruas në familje sjell stabilitet, duke ndikuar në një gjendje më të mirë emocionale dhe psikologjike.”¹⁰⁷

Duke qenë se mundësitë nuk janë të barabarta varësisht zonës urbane apo rurale, nga diskutimet kemi vërejtur një ndikim shumë më të madh të hapjes së IP në zona rurale. Në fshatin Besi, pas hapjes së kopshtit me bazë në komunitet u është dhënë mundësi edhe grave për të kërkuar punë dhe për t'u punësuar. Tre prej tyre pohuan se janë punësuar pasi është hapur IP në këtë fshat, duke i'u mundësuar fëmijëve të tyre të kenë qasje në edukimin e hershëm dhe atyre mundësi për të kërkuar punë.

Megjithatë gjendja e rënduar ekonomike dhe niveli i lartë i varfërisë në Kosovë (ku 18.0% e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë dhe 5.1% nën kufirin e varfërisë së skajshme¹⁰⁸) bën që kostot për IP të jenë të pa përballueshme. Mungesa e shërbimeve të përballueshme të kujdesit për fëmijët në Kosovë është po ashtu kontribuesi kryesor në pengimin e qasjes së grave në tregun e punës.¹⁰⁹ Me këtë pajtohen edhe 88.73% e prindërve pjesëmarrës në hulumtim, të cilët mendojnë se në rast se pagesa mujore e dedikuar për IP do të ishte më e përballueshme do të ndikonte në përfshirjen e grave në tregun e punës.


¹⁰⁵ Fokus grupi me prindër të IP privat, Prishtinë, 2019

¹⁰⁷ Fokus grup me prindër të IP publik, Prishtinë, 2019

¹⁰⁸ Rezultatet e Varfërisë në Konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012-2017

<https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-varferise-2012-2017>

¹⁰⁹ “Jo aktiviteti i grave në tregun e punës”, D4D https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D_PI_12_W4D_SHQ_WEB.pdf



Në mesin e sfidave dhe sakrificave të shumta hyjnë edhe problemet me të cilat përballen gratë e punësuara në sektorin privat. Një nënë gjatë diskutimeve deklaroi se është detyruar t'a lërë punën pasi fëmiju është sëmurë shpesh kur ka filluar çerdhen. Ndërsa nuk ka hasur mirëkuptim nga punëdhënësi në këtë sektor.¹¹⁰



¹¹⁰Fokus grupi me prindër të IP publik, Prishtinë, 2019

REKOMANDIMET

- ◆ Të orientohen investimet e Qeverisë dhe MASHT-it drejt edukimit të hershëm.
- ◆ Të krijohen kushtet për hapje të IP-ve të të gjitha organizimeve duke vënë edukimin e hershëm të institucionalizuar si prioritet në zhvillimin e politikave si dhe ndarjen buxhetore.
- ◆ Të angazhohen komunat e Kosovës duke aktivizuar dhe informuar komunitetin për mundësitë e krijimit të kopshteve pasi po rezulton si një formë e suksesshme e organizimit dhe e përballueshme për xhepin e qytetarëve.
- ◆ Të përpilohet urgjentisht Kurrikula për Edukimin Parashkollor dhe t'i jepet fund interesave të tjera përveq atyre në të mirë të fëmijëve. Grupi punues rekomandohet të jetë pjesë e ekspertëve të edukimit të hershëm, në mënyrë që fëmijët të edukohen në nivel me hulumtimet shkencore globale për fëmijërinë e hershme. Kurrikula duhet të jetë e bazuar në lojë si një mënyrë efektive për të rritur kreativitetin e fëmijëve.
- ◆ Kërkohet angazhim më i madh i shoqërisë civile për kërkim llogaridhënie nga ana e institucioneve në lidhje me edukimin e hershëm, ligjet dhe rregulloret që ata hartojnë.
- ◆ Investimi në edukim të hershëm kërkon veprime të menjëhershme. Për këtë arsye rekomandohet që derisa të hapen IP të reja, sidomos në fshatra, të investohet në qendra me bazë në komunitet me qëndrim deri në 2 orë.
- ◆ Kështu do të adaptohen fëmijët ngadalë deri sa të ndërtohen IP në afërsi.
- ◆ Të aprovohet ligji për edukimin parashkollor, sapo të krijohen kushtet për një gjë të tillë, në mënyrë që IP me bazë në komunitet t'u njihet statusi si të tilla.
- ◆ Të investohet në kërkim dhe më pas në implementim të formave të tjera të organizimit, të cilat do t'u mundësonin fëmijëve qasje sa më të hershme në edukim parashkollor dhe grave mundësi për qasje në tregun e punës.
- ◆ Sektori privat rekomandohet të tregojnë mirëkuptim për prindërit në periudhën e fillimit të dërgimit të fëmijëve në IP. Kjo pasi koha e adaptimit të fëmijëve mund të kërkojë orë të lira shtesë të prindërve nga puna.
- ◆ Kompanive private gjithashtu u rekomandohet krijimi i kopshteve brenda kompanisë për fëmijët e punonjësve. Kjo do të ishte frytdhënëse për fëmijët pasi do u krijonte qasje në edukim të hershëm dhe do të rriste produktivitetin tek punonjësit.

Bibliografia

- Agjencia e Statistikave të Kosovës – Regjistrimi i popullsisë në Kosovë 2011 (<http://ask.rks-gov.net/>).
- Agjencia e Statistikave të Kosovës <http://ask.rks-gov.net/media/5060/anketa-e-fugis%C3%AB-pun%C3%ABtore-tm2-2019.pdf>
- Bissoli, M. D. F. (2014). Development of Children's Personality: The role of early childhood education. *Psicologia em Estudo*, 19(4), 587-597.
- Center on the Developing Child, Harvard University. <https://46y5eh11fhgw3ve3ytpwxt9r-wpengine.netdna-ssl.com/wp-content/uploads/2007/03/InBrief-The-Science-of-Early-Childhood-Development2.pdf>
- Early Child Development : A Powerful Equalizer – World Health Organization, March 2007
- Ginsburg, K. R. (2007). The importance of play in promoting healthy child development and maintaining strong parent-child bonds. *Pediatrics*, 119(1), 182-191.
- IDRA Research & Consulting – Kosova
- Insitucionet e Licencuara Edukativo Arsimore Parashkollore, MASHT, 2018 <https://masht.rks-gov.net/divizioni-per-arsim-privat-parauniversitar>
- Institucionet shkollore publike: amë dhe paralele të ndara, Statistikat e Arsimit 2017/2018 <https://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>
- KEEN, Edukimi parashkollor në Kosovë http://keen-ks.net/site/assets/files/1445/edukimi_parashkollor_ne_kosove_alb.pdf
- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, MASHT, 2016, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>
- Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>
- Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç, MASHT https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/kurrikula-e-edukimitparashkollor-ne-kosove-3-6-vjec_1.pdf
- Ligji Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor, 2006; <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/7-lep-ligji-mbi-eukimin-parashkollor.pdf>
- Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës; <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/9ligji-i-arsimit-nekomuna2008-03-l068-al-ar-se-kom.pdf>
- Ligji nr. 04/ L-032 për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, 2011. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>
- Përfshirja e fëmijëve në Institucione parashkollore në Kosovë, MASHT, UA 19/2016, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15178>
- Plani Strategjik për Arsim në Kosovë 2017 – 2021; https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf
- Plani Zhvillimor i Arsimit në Prishtinë 2018-2022 <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/Plani-Zhvillimor-i-Arsimit-PRISHTINE-ALB.pdf>
- Raporti "Jo aktiviteti i grave në tregun e punës", D4D https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D_PI_12_W4D_SHQ_ËEB.pdf
- Raporti "Kush kujdeset? Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë.", Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), Prishtinë, 2016

Rates of return to human capital investment. "Policies to Foster Human Capital,"
Research in Economics

Rezultatet e Varfërisë në Konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012-2017
<https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-varferise-2012-2017>

Rozafa Shala, Alternativat e metodologjive të edukimit parashkollor dhe aplikimi i tyre në Kosovë, Punim i doktoratës, Tiranë, 2017. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/07/Rozafa-Shala-Disertacioni-Finale-25.12.2017.pdf>

Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN – Edukimi parashkollor në Kosovë, hulumtim. [http://keen-](http://keen-ks.net/site/assets/files/1445/edukimi_parashkollor_ne_kosove_alb.pdf)

[ks.net/site/assets/files/1445/edukimi_parashkollor_ne_kosove_alb.pdf](http://keen-ks.net/site/assets/files/1445/edukimi_parashkollor_ne_kosove_alb.pdf)

Shënime statistikore Arsimit parauniversitar, MASHT, 2017/2018 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/03/shenime-statistikore-2017-18-arsimi-parauniversitar.pdf>

Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, 0 deri 6 vet, MASHT, 2011, https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-web_1.pdf

Statistikat e arsimit në Kosovë 2018/2019, MASHT dhe ASK, <http://ask.rks-gov.net/media/5055/statistikat-e-arsimit-2018-2019.pdf>

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 [http://www.kryeministri-](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf)
[ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf)

The Science of Early Childhood Development, Center on the Developing Child, Harvard University <https://developingchild.harvard.edu/resources/inbrief-science-of-eecd/>

Three Core Concepts in Early Development, Center on the Developing Child, Harvard University. <https://46y5eh11fhgw3ve3ytpwxt9r-wpengine.netdna-ssl.com/wp-content/uploads/2007/03/InBrief-The-Science-of-Early-Childhood-Development2.pdf>

Udhëzimi administrativ 42/2007 - Kushtet dhe mundësitë e përkrahjes së edukimit parashkollor nga komuniteti

Udhëzimi administrativ për licencimin dhe regjistrimin e institucioneve edukative-arsimore parashkollore, 2011 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8054>

UNICEF Report, Early moments matter for every child

https://www.unicef.org/publications/files/UNICEF_Early_Moments_Matter_for_Every_Child.pdf



Young Children Develop in an Environment of Relationships, Center on the Developing Child, Harvard University

Zbatimi i Standardeve të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë, MASHT, UA 12/2006 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ua-standardet.pdf>


Shtojcat

Shtojca 1. Informata demografike


Prej respondentëve që kanë marrë pjesë në hulumtim, 50% ishin gra dhe 50% burra. (Grafiku 18) Ndërsa, siç ilustron Grafiku 19, shumica e respondentëve kanë qenë të moshës 33-38 vjeç (44.44%) dhe 27-32 vjeç (30.56%).



Sa i përket statusit të punësimit, 81.69% e grave dhe burrave kanë qenë të punësuar, vetëm 7.04% ishin të papunësuar por duke kërkuar punë dhe 5.63% e respondentëve ishin të papunësuar duke mos kërkuar punë. (Grafiku 20)



Siç shpjegohet në metodologji, është planifikuar që reprezentimi i mostrës të jetë i barabartë sa i përket zonës urbane dhe rurale. Por, meqenëse ka mungesë të kopshteve në zona rurale nuk është arritur të realizohet ky përfaqësim. Kështu, 76.39% e respondentëve janë shprehur se jetojnë në zona urbane dhe 23.61% në zona rurale. (Grafiku 2)



Shtojca 2. Pyetëtori

Instrumenti i përdorur gjatë fokus grupeve është dizajnuar në formë të pyetësit, i cili është plotësuar para bashkëbisedimit me prindër të IP-ve të përzgjedhura. Ky pyetësor përbëhet prej tre moduleve, që përfshijnë:

INFORMATA PËR RESPONDENTIN

Emri dhe Mbiemri _____

Numri i Telefonit
apo E-mail Adresa _____

Gjinia: ✓



Grua

☐


Burrë

☐

Mosha:

☐ 20 deri 26

☐ 39 deri 44

☐ 27 deri 32

☐ 45 deri 50

☐ 33 deri 38

☐ > 50

Statusi juaj i punësimit:

- ☐ I/E punësuar
 - ☐ I/E punësuar kohë pas kohe
 - ☐ I/E papunësuar, duke kërkuar punë
 - ☐ I/E papunësuar, duke mos kërkuar punë
-

Sa fëmijë i keni për momentin në çerdhe?

- ☐ 1
 - ☐ 2
 - ☐ Më shumë se dy (ju lutem specifikoni): _____
-

Sa vjeç është fëmiu/fëmijët që ju i keni në çerdhe?

- ☐ Më i vogël se 1 vjeçar/re
 - ☐ 1 deri në 2 vjeçar/re
 - ☐ 2 deri në 3 vjeçar/re
 - ☐ 3 deri në 4 vjeçar/re
 - ☐ 4 deri në 5 vjeçar/re
-

Sa shpenzoni në muaj nga buxheti i përgjithshëm familjar
për të paguar shpenzimet e çerdes për fëmion/jët tuaj?

- ☐ Më pak se 50 EUR
 - ☐ 50 deri në 100 EUR
 - ☐ 100 deri në 150 EUR
 - ☐ 150 deri në 200 EUR
 - ☐ <200, ju lutem specifikoni: _____ €
-

Sa janë të ardhurat totale mujore të familjes tuaj?

- ☐ Më pak se 500 EUR
- ☐ 500 deri 1000 EUR
- ☐ Më shumë se 1000 EUR

Sa jeni të kënaqur me përgatitjet profesionale të personelit mësimor në çerdhe?

- ☐ Shumë të kënaqur
- ☐ Të kënaqur
- ☐ Të pakënaqur
- ☐ Aspak të kënaqur

Sa jeni të kënaqur me pajisjet e argëtimit të ofruara në çerdhe, duke ju referuar në këtë rast: lodrave për fëmijë dhe hapësirave rekreative?

- ☐ Shumë të kënaqur, çerdhja i ofron të gjitha pajisjet e nevojshme që fëmiju im të argëtohet
- ☐ Të kënaqur, çerdhja posedon pajisje relativisht të mjaftueshme që fëmiju im të argëtohet
- ☐ Të pakënaqur, çerdhja nuk ka pajisje dhe hapësira të nevojshme për rekreativitet
- ☐ Aspak të kënaqur, çerdhja nuk i plotëson kushtet elementare për rekreativitet

Nëse përgjigjja juaj është nga 2 deri në 4 ju lutem specifikoni saktë se çfarë i mungon çerdhes ku ju e dërgoni fëmijun/jët tuaj:

- ☐ Sa jeni të kënaqur me ushqimin që ofrohet në çerdhen ku ju e dërgoni fëmijun/jët tuaj?
- ☐ Shumë të kënaqur, çerdhja ofron menu të shëndetshme
- ☐ Të kënaqur, çerdhja ofron menu të larmishme
- ☐ Të pakënaqur, çerdhja ofron menu të pa-shëndetshme
- ☐ Aspak të kënaqur, çerdhja ofron menu të pa-shëndetshme dhe të pa-shijshme

Nëse përgjigjja juaj është nga 2 deri në 4 ju lutem specifikoni saktë se si mund të përmirësohet cilësia e ushqimit në çerdhen ku ju e dërgoni fëmijun/jët tuaj:

- ☐ Ju lutem na tregoni se sa ka ndikuar që fëmiju/jët tuaj të jenë më të socializuar prej momentit që ai/ajo ndjek edukimin në çerdhen përkatëse?
- ☐ Ndikim dukshëm pozitiv
- ☐ Njëjtë, fëmiju im nuk ka përmirësim apo degradim në këtë aspekt
- ☐ Ndikim negativ
- ☐ Tjetër _____ (Ju lutem specifikoni)

Sa është rregulluar gjumi i fëmijt/jëve tuaj dhe në përgjithësi
e gjithë rutina, nga momenti që e keni dërguar atë në çerdhe?

- ☐ Fëmij im gjithnjë ka pasur gjumë të rregullt
- ☐ Gjumi i fëmijt tim është përmirësuar
- ☐ Gjumi i fëmijt tim është çrregulluar plotësisht
- ☐ Tjetër _____ (të lutem specifikoj)

A është ngacmuar (bullying) fëmija juaj ndonjëherë brenda
ambienteve të çerdes, përfshirë këtu nga fëmijët e tjerë apo nga mësueset?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di

*Sqarim: Me fjalën ngacmim nënkuptojmë abuzim fizik dhe abuzim psikik.
Nëse përgjigjja juaj është PO, ju lutem kaloni tek pyetja në vazhdim me numër 15,
në të kundërtën ju lutem kaloni tek pyetja e 18-të.*

Nga kush është ngacmuar fëmiju juaj?

- ☐ Fëmijët e tjerë në çerdhe
- ☐ Nga njëra prej edukatoreve
- ☐ Nga drejtori/esha dhe pjesëtarë të tjerë të stafit menaxherial

Sa shpesh është ngacmuar fëmiju/jët tuaj?

- ☐ Asnjëherë
- ☐ 1 herë
- ☐ 2 deri 5 herë
- ☐ 5 deri në 10 herë
- ☐ Më shumë se 10 herë

Ku i adresoni ankesat tuaja dhe a merren ato parasysh?

- ☐ Tek edukatorja, ankesa merret parasysh
- ☐ Tek drejtori/sha, ankesa merret parasysh
- ☐ Tek edukatoja, ankesa nuk merret parasysh
- ☐ Tek drejtori/sha, ankesa nuk merret parasysh
- ☐ Tjetër, _____ (ju lutem specifikoni)

A preferoni më shumë që
fëmiu/jët tuaj të vijnë çerdhet:

- ☐ Publike
- ☐ Private
- ☐ Me bazë në komunitet
- ☐ Me partneritet publiko-privat

RRITJA E NUMRIT TË ÇERDHEVE DHE EMANCIPIIMI I GRUAS

Në rast se pagesa mujore për çerdhe është dukshëm më e përballueshme, a mendoni që ky aspekt do të paraqiste lehtësira për gratë të kycen në tregun e punës?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di

Sa mendoni që pozita e gruas në shoqëri do të përmirësohej dukshëm në rast se të gjitha familjet do të mund ti dërgonin fëmijët e tyre në çerdhe?

- ☐ Pajtohem
- ☐ Nuk pajtohem me këtë hipotezë
- ☐ Nuk e di

Komente shtesë:



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**
Büro Kosovo



Ky publikim është punë vullnetare e autorëve, përkrahur nga **Friedrich Ebert Stiftung**, zyra në Prishtinë. Përmbajtja, qëndrimet dhe përfundimet në këtë publikim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht i paraqesin edhe qëndrimet e Fondacionit **Friedrich Ebert Stiftung**.

Publikimi është i qasshëm online në: www.fes-kosovo.org

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**

Büro Kosovo



KOSOVA

që duam



PSE EDUKIMI I HERSHËM ËSHTË ZGJIDHJA?

AUTORË:

**MAJLINDA BEHRAMI
FITIM PACOLLI
FLORENT RAMQAJ**

2020